



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:154976

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05449198

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.815/2023

GJYKATA THEMELORE GJILAN Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, ne çështjen penale kundër të pandehurit E. Z. nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare av.H. H. nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilani, PP.II.nr...../2023 të datës 08.11.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 13.02.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.03.2024, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E. Z., nga babai B. dhe nëna P., e gjinisë Sh., i lindur me datë, në Gjilani, ku edhe jeton, në rr."T. A.",nr..., me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 01.10.2022, rreth orës 19:25, në rrugën Gjilani - Preshevë, i pandehuri, nga pakujdesia, ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit, duke rrezikuar trafikun publik, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që: derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës VW „G...”..., ngjyrë e zezë, me tabela 06-....-..., ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 53.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, duke mos e përshtatur shpejtësinë e automjetit, me kushtet e rrugës, ashtu që me të kaluar fshatin Velekincë, e ka goditur në pjesën e pasme të rimorkios - traktorin e markës „IMT”’, ngjyrë e kuqe, me tabela 06-....-..., pa regjistrim dhe pa patentë shofer, të cilin e drejtonte B. S., pa sinjalizim ndriçues – nuk ka pasur të ndezur asnjë dritë mbrapa në traktor e as në rimorkio, madje as katadiopter në pjesën e pasme të gjysmë rimorkios, përveç një dritë të vogël me

ngjyrë të kuqe që e kishte të vendosur në dritën e përparme të anës së majtë të traktorit, ku nga forca goditëse traktori me rimorkio përfundojnë jashtë rruge në anën e majtë, me ç'rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore, ku lëndime të rënda trupore pëson, tani i dëmtuari B. S., i cili transferohet në QKUK në Prishtinë, ndërsa lëndime të lehta trupore pëson E. Z., i cili kërkon ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan - Emergjencë;

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 KPRK-së

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës, të pandehurin e lartcekur:

E G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muaj**, ashtu që me propozimin dhe me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, të pandehurit të lartcekur, dënimi i shqiptuar me burgim i **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumën prej **500 (pesëqind-euro) €**, të cilin gjobë i njëjti është i obliguar ta paguajë në afat prej 60 ditësh, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri i lartcekur, nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

I dëmtuari B. S., nga fshati R., Komuna e Vitisë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzet e pesë euro), si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë-euro) për kompensimin e viktimave të krimit, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 01.10.2022, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr...../2023, kundër të pandehurit E. Z. nga Gjilani, për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-ës.

Me datë 13.02.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezentë prokurorja e shtetit, Leonora Kadriu, i pandehuri E. Z. dhe mbrojtësi i tij av.H.H., me ç'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri i

lartcekur pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njëjti deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, gjithashtu ka shtuar se kjo ka ndodhur pa dashje dhe nga pa kujdesia, andaj i premtonte gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris këtë veprë apo veprë tjetër penale duke kërkuar që ti shqiptohet një dënim më i butë dhe ka propozuar që mundësisht dënimin me burg të i zëvendësohet në dënim me gjobë. me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve dhe më pas seanca e shqyrtimit fillestar ka vazhduar me deklaratimet e palëve rreth dënimit.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 242 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Deklarata e të pandehurit E. Z., kallëzimi penal i paraqitur nga ankuesi B. S., aktvendimi mbi hedhjen e kallëzimit penal PP.II. nr.../23 e datës 01.02.2023, kërkesa për përfillimin e procedurës kundërvajtës PA-...../23 e datës 01.02.2023 kundër B. S., ekspertiza mjeko -ligjore e datës 18.01.2023, me konstatimin se E. Z. ka pësuar dëmtime të lehta trupore, me pasojat të përkohshme për shëndetin, flete lëshimi nga QKUK i datës 29.12.2022 në emër B. S., ekspertiza mjeko - ligjore e datës 31.07.2023, me konstatimin se B. S., ka pësuar gjak mbledhje nën cipat e forta të trurit në anën e majtë, thyerje serike e brinjëve prej 9-11 në anën e djathtë të kafazit të kraharorit, gjakderdhje nën cipat e buta të trurit dhe gjak mbledhje mbi pjesën kockore të kafkës djathtas, që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, ekspertiza e komunikacionit e datës 25.01.2023, me konstatimin se deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimit të B. S., ekspertiza e komunikacionit e datës 26.06.2023, me konstatimin se shkaktar i aksidentit në komunikacion ishte ngasësi i mjetit bujqësor - traktori –B. S., ndërsa kontribuues i aksidentit në komunikacion ishte ngasësi i automjetit „VW G...” – E. Z., super ekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit e datës 24.10.2023, me konstatimin se deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimit të drejtuesit të mjetit - traktor IMT- B. S. dhe kontributit që lidhen me pasojat e aksidentit të drejtuesit të automjetit „VW ...”- E. Z., si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri E. Z., e ka kryer veprën penale: rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-ës, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind-euro)€, të cilin dënim obligohet ta paguajë në afat prej 60 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71, dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilën i vihen në barrë në një fazë të hershme të procedurës, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori për bazë shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore, e cila veprë penale është në rritje e sipër, dashjen e të pandehurit për ta kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor siç shihet në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në të lartë cekurat dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 73 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike Gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 për realizmin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e lartëcekur e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil. Ndërsa përfaqësuesja e të dëmtuarit L. J. ka deklaruar se sa i përket ndjekjes penale nuk i bashkëngjitem, por do të ushtrojmë kërkesë pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzete pesë-euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë-euro) për kompensimin e viktimave të krimin, të gjitha këto pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

**P.nr.815/2023,
me datë 13.03.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Mevlide Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.